

Bejadin Ameti, PhD<sup>1</sup>

Avni Avdiu, PhD<sup>2</sup>

UDC:

316.48-0292:2

**REFLEKSIONET FILOZOFIKE, SOCIOLOGJIKE DHE  
PSIKOLOGJIKE MBI RELIGJIONIN**

**ФИЛОСОФСКИ, СОЦИОЛОШКИ И ПСИХОЛОШКИ  
РЕФЛЕКЦИИ НА РЕЛИГИЈАТА**

**PHILOSOPHICAL, SOCIOLOGICAL AND PSYCHOLOGICAL  
REFLECTIONS ON RELIGION**

**Abstract**

Throughout human history there have been many different beliefs. There have also been many authors who have written pro and against religion. The debate on religion has not yet stopped. The party that emphasizes that religions have been harmful to the individual and society relies on the fact that religious people are mainly seen with introvert withdrawal, lack of interest in life and being illusory, while religious society is seen as aggressive to science, intolerant and conflicting with those of the faith and with any backwardness in any respect. Meanwhile, the party that emphasizes that the religions have been useful relies on the fact that the religious individual is more moral, more sympathetic, more stoically defies the problems and is less or not at all problematic, while the religious society is more compact, cohesive and is more spared from negative phenomena, bad deeds, and bad elements.

---

<sup>1</sup> PH.D. in Faculty of Islamic Studies, Skopje, Republic of Macedonia  
(konba@hotmail.de)

<sup>2</sup> PH.D. in Philosophy and PH.D. in Sociology

As for how sensitive this topic has been, is and remains to be implies the fact that pro-contra debates are still done under tension. Moreover, of greater importance for the debaters had been the dominance and the imposition of their position. Controversies, clashes, and conflicts that have been the basis of the phenomenon have often escalated into violence or fierce warfare. Even worse, in some cases, they are even developed between religions or sects within the same type. And then, not in vain, the researcher Samuel Huntington in his book *“Clash of Civilizations”* cautioned that contemporary wars in the future will be wars of religious character.

To understand the true dimension of religion, it must be seen from the philosophical, psychological and sociological point of view.

**Key words:** religion, philosophy, sociology, psychology, belief, conviction, science, cognition

## FILOZOFIA

Filozofët kishin për qëllim njohjen dhe arritjen e së vërtetës. Secili prej tyre e bënte këtë brenda mundësive të veta. Asnjëri s'ka mundur të gjykojë jashtë temperamentit dhe formimit të tij. Filozofia i jep prioritet mendjes-arsyes, ndërsa religjioni besimit-bindjes. “Religjioni, në fakt, nuk është identik me filozofinë, e cila nuk sjell doemos ngushëllimet që di t'i ofrojë religjioni” (Levinas, E., 2003:135). Nëse shfletojmë filozofitë e ndryshme nga lashtësia e gjer tek ato bashkëkohore, vërejmë qasje të ndryshme, shpesh jo të qëndrueshme e të kundërthënshme. Me pak fjalë, problemin e filozofisë për të dhënë një tablo për jetën, botën dhe dukuritë brenda tyre e ka përkufizuar filozofi Umberto Eco, sipas të cilit “filozofia kryen njërin nga krimet e saj më të rënda, duke mos thënë asgjë nga nxitimi për t'i thënë të tëra” (Eco, U., 2003:339). Përballë filozofisë, individit u ndodh gjithnjë nën trysninë e ‘habisë’ [Zhan Hersh]. Ai “i ngjante një spektatori që shihte vetëm një pamje tepër të vogël të veprës që sodiste - mbase këndvështrimi i tërësisë, ai i vetmi nga ku mund të fitohet perspektiva e duhur, i përket Zotit” (Ferri, L., 2002:75). Një pjesë dërrmuese e filozofëve besonin në Një Zot, por kishte të tillë që ishin skeptikë, agnostikë, deistë, dhe ateistë; ateist madje si Lametri, që edhe blasfemonte. Filozofi i madh antik Sokrati u dënua me vdekje sepse thirrte në besimin në një Zot, kundrejt besimit zyrtar shtetëror. Tek *‘Apologjia e Sokratit, Kritoni, Fedoni’*, Platoni përcjell fjalët e mësuesit të tij: “O

Athinas, vetëm Zoti është i Gjithëdijshtëm... se dituria njerëzore është krejt e papërfillshme, madje hiç i vërtetë... dua t'ju bindi, të rinj a pleq qofshi, të mos i jepni shumë rëndësi trupit dhe të mirave materiale, por shpirtit tuaj, të cilin duhet ta përsosni vazhdimisht". I njëjti burim përcjell se Sokrati iu drejtua atyre që e dënuan me këto fjalë: "Unë po shkoj i dënuar prej jush me vdekje, por mos harroni se ju jeni damkosur nga e vërteta, me turp e padrejtësi të përjetshme. Ashtu si po e pranoj unë dënimin tim, ashtu duhet ta mbani edhe ju turpin tuaj". Po ashtu, tek *'Apologjia e Sokratit, Kritoni, Fedoni'*, Platoni transmeton fjalët e Sokratit: "Ç'gjë e çuditshme, o miq, është ajo që njerëzit e quajnë kënaqësi. Ç'lidhje interesante midis kësaj dhe të kundërtës, që është dhimbja. Të dyja bashkëjetojnë te njeriu, megjithatë luftojnë njëra me tjetrën dhe ai që arrinë ta kapë njërin, gjithmonë është i detyruar ta pranojë edhe tjetrën, kështu që, edhe pse janë dy, duken si të lidhura në një rrfanë. Zoti, duke dashur t'i pajtojë këto dy kundërshti në luftë të përjetshme mes tyre, i lidhi ngushtë me njëra-tjetrën, kështu që, nga shkon njëra, pas i vjen edhe tjetra. Ja përse nuk trishtohem si të tjerët nga mendimi i vdekjes, përkundrazi, ngushëllohem nga shpresa se përtej vdekjes, siç thuhet prej kohësh, do të ketë diçka të vlerë, si për të mirët, ashtu edhe për keqbërësit". Sikurse nënkuptohet nga këto fjalë, krahas besimit në Zot, Sokrati besonte edhe në jetën e pasvdekjes, në ringjalljen, shpërblimin dhe dënimin nga Zoti, varësisht nga veprat e njeriut.

Pararendësi i demokracisë liberale, Xhon Loku, në veprën e tij *"Letër për tolerimin"*, në mes tjerash shkruan: "Tërë jeta dhe fuqia e fesë së vërtetë qëndron te bindja e brendshme dhe e plotë e mendjes... cilido qoftë shqiptimi ynë i besimit, cilido qoftë adhurimi ynë i jashtëm, po të mos jemi plotësisht të bindur në mendjen tonë..., ky shqiptim dhe ky adhurim, janë me të vërtetë pengesa të mëdha për shpëtimin tonë... Vetëm besimi dhe çiltërsia e brendshme pranohet nga Zoti... Zoti është i vetmi Gjykatës, i Cili ditën e mbrame do të shpaguajë çdo njeri, në përputhje me të bëmat përkatëse, domethënë, sipas sinqeritetit dhe drejtësisë së dëshmuar... Në radhë të parë, kujdesi kryesor i çdo njeriu duhet të jetë për shpirtin e vet dhe pastaj për paqen publike... Ata që nuk duhen toleruar fare, janë mohuesit e ekzistencës së Zotit... Heqja e Zotit, qoftë edhe vetëm si mendim, shpërbën gjithçka. Përveç kësaj, ata që me ateizmin e vet minojnë dhe shkatërrojnë fenë krejt, nuk mund ta përdorin atë si pretekst për të sfiduar privilegjin e tolerimit..., feja nuk duhet t'i detyrohet askujt, as

me ligj as me dhunë (Locke, J., 2002:17, 37, 56, 59, 60). Në këtë kontekst edhe Francis Bejken, tek "Atlantida e Re" pohon: "Nuk guxojmë ta përhapim religjionin nëpërmjet luftërash ose farë ndjekjesh të përgjakshme..." (Bacon, F., 1982:14).

Ateizmi asgjëson fisnikërinë dhe ngritjen e natyrës njerëzore dhe në çdo pikëpamje është i urrejtshëm. George Berkeley te 'Traktat mbi parimet e njohjes njerëzore', theksoi se "ateistët janë viktimë të miopisë dhe karakterit të ngushtë të pikëpamjes së tyre... Zoti është Një, i Përjetshëm, pafundësisht i Urtë, i Mirë e i Përsosur... që bën gjithçka në çdo gjë dhe për hirë të së cilës ekzistojnë të gjitha sendet. Është, pra, e qartë se Zoti njihet po aq me siguri e drejtpërdrejtë si çfarëdo mendje tjetër ose frymë e ndryshme nga vetë ne. Madje mund të pohojmë se ekzistenca e Zotit perceptohet në mënyrë shumë më të qartë se ekzistenca e njerëzve, sepse efektet e natyrës janë pafundësisht më të shumta dhe bien në sy më shumë sesa ato që u atribuohet vepruesve njerëzorë... Megjithatë, kjo dritë e kulluar dhe e qartë që ndriçon secilin është në vetvete e padukshme... Po ta shihnim Atë, thonë ata, ashtu si shohim një njeri, do të besonim se Ai ekziston dhe do t'u bindeshim urdhrave të Tij. Medet! Për cilindo që është në gjendje të gjykojë sadopak, nuk mund të ketë kurrgjë më të qartë sesa ekzistenca e Zotit... Ai është me ne... dhe se Ai është i pranishëm dhe i vetëdijshëm për mendimet tona më të fshehta dhe ne jemi në varësinë më të plotë dhe të drejtpërdrejtë prej Tij. Vizioni i qartë i këtyre të vërtetave të mëdha nuk mund të mos mbushë zemrat tona me një maturi të përvujatur e frikë prej Perendisë, që është nxitja më e fortë drejt virtutit dhe mbrojtja më e mirë kundër vesit". (Berkeley, G., 2002:8,128,129,134).

Tek Imanuel Kanti, meqë mendja dhe arsyeja janë të pafuqishme dhe pllakosen në antinomi kur parashtrahet çfarëdo çështje metafizike e transcendentale, sikurse dëshmohet në veprën '*Kritika e mendjes së kulluar*', atëherë Zoti derivohet nga aspekti praktik moral për ç'gjë dëshmon '*Kritika e mendjes praktike*', e cila synon t'i përgjigjet pyetjes "Çfarë duhet të bëj unë?". "Unë duhet ta bëj", - ky është i vetmi motivim moral - një thirrje, një kërkesë e qartë. Njeriu i jep vetes autonominë që i thotë: "Bëje këtë, sepse ti duhet ta bësh!". Unë duhet ta bëj, sepse ashtu duhet, e s'bën ndryshe. Nuk ka motiv tjetër. Vlera morale përjetohet drejtpërdrejt *a priori*. Nuk varet nga ndonjë rezultat i jashtëm, rrethanë, a përvojë e caktuar. Ajo është e vlefshme në vete. Mendja dhe liria e vullnetit janë të lidhura ngushtë

dhe reciprokisht. Në qendër të konceptit të autonomisë së vullnetit është ideja e lirisë. Vullneti i mirë i jep vetes ligjin e vet - autonominë e vullnetit. Vetëm vullneti mendor në kuptim të plotë është autonom dhe i lirë. Vullneti i mirë është i mirë në vetvete. Vendi i vlerave morale është te vullneti i mirë. Vullneti i mirë është ai që na bën të jemi në pajtim me vlerat morale. Autonomia është statusi i vullnetit që i jep vetes ligjin e tij. Auto - vetvete dhe nomos - ligj. Forma e moralitetit është ligji. Gjithçka në natyrë vepron në përputhje me ligjet. Mirëpo vetëm njeriu ka aftësi që të veprojë në përputhje me konceptet e ligjeve. Bindja ndaj ligjit nuk duhet të bazohet tek interesi, pasi që interesi mund të lejojë trajtimin e njerëzve si mjete për të arritur qëllime të caktuara. Njerëzit duhet ta dinë se ata janë krijues të ligjeve dhe të nënshtruar ndaj ligjeve. Për pasojë bindja ndaj ligjeve duhet të jetë e pakushtëzuar. Një shoqëri të tillë Kanti e quan mbretëria e qëllimeve. Liria është të bindesh ndaj detyrës, aftësia për autonomi. Dhe ky ligj është bindja ndaj detyrës: “Unë duhet ta bëj”. Bindja ndaj detyrës është i vetmi motivim moral me thirrje dhe kërkesë të qartë. Fjala e Kantit: “Ti mundesh, sepse ti duhet ta bësh!”, - nënkupton mundësinë e zgjedhjes. E kjo është liria. Morali nënkupton lirinë. Kur ne veprojmë moralisht, ne jemi të lirë. Pra, me fjalë të tjera, ‘ti je një subjekt i lirë, meqë ti e gjen në vete kuptimin e detyrës’. Liria dhe morali kushtëzohen mes veti, pra në atë se çfarë është njeriu jashtë perceptimit shqisor, se si sillet ai kur është i lirë - aty dhe pikërisht në ato momente del lakuriq morali i tij - se çfarë është në të vërtetë ai. Me nocionin e praktikës lidhet edhe nocioni i lirisë, kurse edhe parimi i lirisë është në sferën e mendjes. T’i bindesh detyrës nuk është shtrëngesë, por liri. Liria nënkupton autonominë, që ne vetë të vendosim për të mos u bërë lodra të ndjenjave dhe parapëlqimeve tona. Ky është imperativi kategorik. Kanti thoshte: *“Unë e njoh veten në dy mënyra, teorikisht si pjesë e natyrës dhe praktikisht si faktor veprues”*.

Njeriu nuk është vetëm arsye, por shumë më i komplikuar. I tërë veprimi etik duhet të mbështetet në mendje. Morali është koncept racional. Ndryshe nga mendja teorike, e kufizuar me fuqitë e veta njohëse, mendja praktike hyn në botën noumenale (gjënë më vete, që s’mund të njihet e pranohet me ndjesi, por mund të mendohet vetëm me arsye). Gjëja më vete, në fund të fundit, është e njohshme me anë të postulateve të mendjes praktike. Mendja na shpie tamam tek ato teori kryesore metafizike që kritika e parë kishte synuar t’i hidhte poshtë. Njeriun e ngrit në pedestal vetëm ligji moral. Ai e dallon nga

gjallesat-speciet e tjera. Deontologjia, pra detyra nuk është gjë tjetër, veçse bindje ndaj ligjit moral, pra bindje ndaj urdhrave të arsyes. Veprimet janë të mira vetëm nëse i kryen për hir të detyrës, pra të pavarura nga pasojat e tyre, për shembull, nuk duhet të vjedhësh, jo se për pasojë ndëshkohesh, por sepse është detyrë morale. Detyra morale kërkon diçka përtej ndjeshmërisë së pasojës. Imperativi kategorik bazohet në parimin e moskontraktitës. Për shembull, nëse individ i mendon se rrena është e mirë dhe e drejtë, atëherë ai duhet ta konsiderojë gënjeshtren si të drejtë universale për të gjithë njerëzimin. Pra, të gjithë njerëzit duhet t'i binden detyrës për të gënjuer. Mirëpo ky parim nuk mund të konsiderohet i drejtë, sepse bie ndesh e në kontraktitë me vetveten. Sikur të gjithë ta quanin të drejtë gënjeshtren, askush nuk do të thoshte të vërtetën, e kështu askush nuk do ta besonte tjetrin. Imperativi kategorik na dikton të veprojmë në atë mënyrë që ta trajtojmë veten dhe të tjerët jo thjesht si mjete për të arritur një qëllim të caktuar, por si qëllim në vetvete. Vullneti heteronom ndikohet nga imperativi hipotetik **NËSE**, që është i kushtëzuar nga emocionet, prirjet, dëshirat... Pra, vullneti heteronom është ai që varet nga rrethana të jashtme. Ai na thotë se një veprim i caktuar është i nevojshëm për të arritur një qëllim të caktuar, sipas formulës, nëse dëshiron pasojën Y, duhet ta bësh X veprimin. Imperativi hipotetik nuk ka karakter detyrues. Mundësia e një zgjedhjeje quhet liri. Kur ne marrim vendim moral, ne jemi të lirë, kurse liria e vërtetë është t'i bindesh detyrës. Në këtë ideal të mbretërisë së qëllimeve, ajo çka është, duhet të jetë, dhe ajo që duhet të jetë, është. E morali duhet të jetë rregullator i veprimit praktik të njerëzve. Vullneti i mirë është burim dhe kriter i moralit - ligj i vetvetes. Veprimet e vërteta morale bëhen për hir të ligjit moral. Ligji moral na drejton të veprojmë ashtu që, jo të bëhemi të lumtur, por që veprimet tona të jenë të drejta. Mendja praktike udhëheq veprimin dhe synon të drejtën. Morali i vërtetë është imperativi kategorik, domosdoshmëri objektive që drejton sjellje të caktuara në mënyrë të menjëhershme, pa pasur për to asnjë qëllim ose kusht tjetër. Nëse një ligj moral është i vlefshëm për mua si qenie racionale, atëherë ai duhet të jetë i vlefshëm për të gjitha qeniet racionale. Një qenie racionale përpiket të bëjë atë që duhet të bëjë. Njeriu nuk është i lirë nëse vepron nën veprimin e instinkteve, epsheve ose të ndonjë interesi. Interesi është sykeq, do të marrë shumë, e nuk jep asgjë. Kanti bën dallimin midis legalitetit që i mvishet veprimit në përputhje me ligjin moral dhe moralitetit që i mvishet veprimit për hir të këtij ligji. Legaliteti

është i mundshëm nëse shtysat që përcaktojnë vullnetin do të ishin fizike, ndërsa moraliteti kërkon që veprimi të kryhet vetëm për hir të detyrës. Nëse një veprim do të jetë moralisht i mirë, nuk mjafton të jetë në përputhje me ligjin moral, por ai duhet të kryhet për hir të ligjit. Ekziston dallimi midis ndërgjegjshmërisë së të vepruarit në përputhje me detyrën dhe të vepruarit prej kësaj, pra prej respektit për detyrën.

Postulati I: **LIRIA**. Idetë janë të domosdoshme për rregullimin e sjelljeve praktike të njerëzve si qenie morale. Ato nuk janë parime konstitutive, por vetëm rregullative të njohjes njerëzore. Te shpirti ka diçka që e kapërcen botën fenomenale. Përjetësi do të thotë se shpirti e tejkalon kohën.

Postulati II: **PAVDEKËSIA E SHPIRTIT**. Ligji moral na çon drejt besimit, d.m.th duhet t'i njohësh të gjitha detyrat si urdhra të shenjta dhe jo si detyrime-shtrëngime. Ato duhet parë nën komandën e një Qenie Supreme, sepse AJO është e vetmja që është e përsosur moralisht dhe me një vullnet të plotfuqishëm, ekzistenca e të Cilit është një kusht që e gjithë tërësia e moralit praktik të ketë një kuptim. Nga ZOTI ne shpresojmë të fitojmë të mirën supreme dhe AI është një lloj garancie, pa të cilën ideja e domosdoshme e Mbretërisë së Qëllimeve do të ishte logjikisht e pakonceptueshme. Në këtë botë njerëzit e mirë zakonisht kalojnë keq dhe nëse nuk është besimi në pavdekshmërinë e shpirtit dhe në ekzistencën e Zotit, i Cili në botën tjetër do të shpërblejë dhe do të dënojë në përputhje me veprimet e njerëzve, atëherë morali kurrsesi nuk do të ishte i mundshëm; kurse pa moral nuk do të mund të ekzistonte çfarëdo qoftë bashkësie.

**ALUDIMI PËR ZOTIN** është postulati i III, si pjesë e pandashme e arsytimit moral. Të gjitha konceptet morale bazohen tek arsyeja. Do të ishte e pamundshme t'i nxirrim ligjet morale nga përvoja, pasi përvoja varet nga rrethanat, ndërsa ligji moral duhet të zbatohet në të gjitha rrethanat. Morali është studimi i asaj çka duhet të ndodhë në botën njerëzore. Një ligj ka forcë morale kur ai bart me vete një domosdoshmëri absolute. Një veprim moralisht i mirë nuk bazohet te pasojat e mira që sjell ai veprim, por te motivi që e shtyn një njeri të veprojë. I vetmi motiv i mirë është ai që nuk merr parasysh pasojat. Te *Kritika e arsyes praktike*, Kanti theksoi: “Vepra në atë mënyrë që parimi i vullnetit tënd të mund të qëndrojë në çdo kohë si parim i ligjvënies universale!” Individu duhet ta imagjinojë botën sikur të gjithë të tjerët do të silleshin të frymëzuar nga i njëjti motiv me të

tijin. Ai mjaftohet vetëm me vënien e një kushti themelor: parimi që motivon sjelljen tënde duhet të ketë mundësi të bëhet ligj universal për sjelljen e të gjithë njerëzimit. Gjithkush të veprojë në mënyrë të tillë, që vullneti ta vlerësojë veten njësoj sikur po arrin nëpërmjet maksimës së tij ligjin universal. Edhe filozofi ateist Fridrih Niçe e pranoi se “në thelb, vetëm frika nga ndëshkimet i mban nën fre njerëzit dhe i lejon secilit të zotërojë me qetësi atë gjë që është e tij”. Ai, edhe pse thirrte në ateizëm, e pranonte se edhe vetë nuk ishte i sigurt në vete dhe se shpesh i zgjohej instinkti i besimit. “Edhe vetë mua që ndonjëherë instikti fetar... më bëhet pa kohë e pa vend i gjallë, në sa mënyra të ndryshme më është zbuluar çdoherë hyjnorja” (Nietzsche, F., 2002:7,194). Te vepra “*Kontrata sociale*”, Zhan Zhak Ruso pranon rolin e mirë të religjionit për shoqërinë, në veçanti të Islamit: “Muhamedi ka pasur pikëpamje shumë të shëndosha. Ai e lidhi ngushtë sistemin e vet politik dhe gjersa forma e qeverisjes së tij ekzistoi nën kalifët pasardhës të tij, kjo qeverisje ishte me të vërtetë një dhe në këtë kuptim e mirë. Mirëpo, arabët që u bënë të lulëzuar, të qytetëruar, të mefshtë (më pas u bënë) frikacakë dhe u robëruan nga barbarët. Atëherë filloi përsëri përçarja midis dy pushteteve. Ndonëse kjo përçarje është më pak e dukshme te muslimanët sesa te krishterët, prapëseprapë ajo ekziston dhe këtu, sidomos në sektin e Aliut dhe ka shtete të tilla si Persia, ku kjo përçarje vazhdon të ndjehet pareshtur” (Ruso, Zh., 1977:170-171). Edhe Nietzsche Friedrich e lavdëroi Islamin duke treguar se “paqe e miqësi me Islamin ndiente edhe gjëni shpirtmadh, më i miri i perandorëve gjermanë Friedrichu I” (Friedrich, N., 2000:82-83).

## PSIKOLOGJIA

Çdo njeri e ndjen nevojë të brendshme besimin në Zot. Është dëshmuar se kjo herë pas here u është shfaqur edhe ateistëve më të zëshëm, të cilët më pas i kanë rrëfyer përvojat e tyre. Në një transmetim që shënoi Muslimi, citohet thënia e pejgamberit Muhamed a.s., të ketë thënë se çdo fëmijë lind në natyrshmërinë e besimit islam, kurse në një hadith kudsij shënohet Zoti të ketë thënë: “Vërtet, Unë i kam krijuar robërit e Mi të pastër në besim, por djajtë i largojnë nga feja e tyre” (Muslimi, v.4:2197).

Sot, “njeriu modern është i shqetësuar dhe gjithnjë e më i hutuar... gjersa bëhet zot i natyrës, ai njëkohësisht bëhet skllav i makinës



që e kanë punuar vetë duart e tij... Ai është për gjithçka, por nuk është për vete... Mirëpo ai duhet t'i japë vetes llogari për vetveten dhe për kuptimin e ekzistencës së tij... Fakti që duhet të vdesë është i pandryshueshëm për njeriun. Njeriu është i vetëdijshëm për këtë fakt dhe pikërisht kjo vetëdije ndikon thellësisht në jetën e tij... “Kemi humbur ndjenjën e kuptimit dhe të veçantisë së individit, se jemi bërë instrument për qëllimet jashtë nesh, se po përjetojmë dhe trajtojmë veten si mall dhe se vetë forcat tona janë tjetërsuar nga ne. Ne jemi bërë sende dhe të afërmit tanë janë bërë sende. Ne jemi kope, duke besuar se rruga të cilën ndjekim, duhet të çojë deri te qëllimi, sepse shohim se të gjithë të tjerët janë në të njëjtën rrugë. Ne jemi në terr dhe po e mbajmë guximin tonë, sepse dëgjojmë se edhe të gjithë të tjerët vërshëlajnë si ne. Dostojevski njëherë pat thënë: “Në qoftë se Zoti ka vdekur, çdo gjë është e lejuar” (From, E., 2003:17,31,50,250). From përcjell fjalët e Isaac Meierit nga libri *‘Time and eternity’*: “Kushdo që flet dhe mendon për një gjë të keqe që ka bërë, mendon për turpin që ka bërë..., ai sigurisht nuk do të jetë i aftë t'i ikë kësaj, sepse fryma e tij do të egërsohet dhe zemra e tij do të kalbet dhe veç kësaj atë mund ta kaplojë një gjendje dëshpërimi. Çfarë do të dëshiroje ti? Lëvize pisllekun këtu dhe bën mirë - ik tërësisht nga e keqja, mos shko rrugës së saj dhe bëj mirë! Ke bërë keq? Pra, rregulloje këtë gjë duke bërë mirë!” (From, E., 2003:136).

Në këtë frymë, Zoti në Kuran jep urdhra të shumta motivuese e nxitëse, si “nxitoni për të bërë mirë”, “të keqen ktheje me të mirë”, “kur të debatoni, flisni në formën më të bukur”, duke premtuar se “veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat” etj. Po ashtu, kjo frymë është përcjellur edhe nga Jezusi (Isai a.s) në formën: “Mos u bëj të tjerëve atë që nuk dëshiron të ta bëjnë ty!”, e që është njëri nga parimet më fundamentale të etikës krishtere. Jesus: “Do for others what you want them to do for you” (Bëj për të tjerët atë që të tjerët dëshiron ta bëjnë për ty). “Çkado që u bën të tjerëve, i bën po ashtu edhe vetes. Vetë rritja jonë, lumturia dhe forca, barazohen në respektimin e këtyre forcave dhe njeriu nuk mund t'i shkelë ato te të tjerët dhe njëkohësisht të mbetet i paprekur” (From, E., 2003:209). Fromi theksoi se Frojdi vjen në përfundimin se çrregullimet psikike është e pamundur të kuptohen duke i shqyrtuar veçmas nga problemet morale të individit, se njeriu është i sëmurë sepse ai le pas dore kërkesat e shpirtit të tij (From, E., 2002:14). Shumë sëmundje të ndryshme psikike që sot i shtyjnë njerëzit drejt stresit, depresionit, neurozave, psikozave etj., në

mes tjerash janë edhe si pasojë e dobësimit të besimit. Të deprimuarit shpesh vendosin t'i japin fund jetës me vetëvrasje e vetëvarje, ose edhe përmes të ashtuquajturës 'vdekje të dinjitetshme' - eutanazisë. Nuk ka ilaç më efikas se besimi i fuqishëm shpirtëror në Zotin, për t'i tejkaluar format e krizave psikike e mendore.

## SOCIOLOGJIA

Është e qartë se shkencat ekzakte nuk ofrojnë asnjë fije përgjigje mbi kuptimësinë e tërë ekzistencës sonë. Në të vërtetë, ato anashkalojnë çështjet vendimtare për humanitetin, duke abstrahuar çdo gjë subjektive si arsyen, vetëdijen, vullnetin, lirinë, shpresën etj. Pikërisht religjioni është ai që e mbush atë hapësirë, të cilën shkenca e le të zbrazët. Ai i plotëson ato nevoja individuale e kolektive, të cilat shkenca nuk mundet. Thjesht, religjioni i zgjidh ato enigma jetësore për të cilat shkenca s'mund të ketë qasje. Shkenca na jep neve teknologjinë, ndriçimin elektrik, telekomunikimin, komunikimin virtual, internetin, satelitët kozmikë dhe deshifron diagnoza, duke pasur sukses në pengimin dhe shërimin e një numri të dukshëm sëmundjesh. Mirëpo, sikurse pohon Max Horkheimer tek *'Errësimi i mendjes'*, "Religjioni në formë të shërbimit shpirtëror ofron kthjelltësi, ekuilibrim moral, fat dhe i pengon format e nduarduarta të sëmundjeve, ashtu sikurse edhe shkenca, madje në disa raste edhe më mirë". Religjioni nuk përfshihet në shpjegimin empirik të fakteve, por në interpretimin vleror të tyre, e vlerat nuk mund të deduktohen nga shkenca. Aty ku ndalet fuqia shpjeguese e shkencës, fillon fuqia ngushëlluese e religjionit, sepse fuqia e religjionit këndellet mu atëherë kur shteret fuqia e shkencës. Shkenca në mënyrë efikase i plotëson nevojat konkrete, por i anashkalon nevojat abstrakte, p.sh: etjen për pavdekshmëri, të mpiksur në qenien e njeriut qysh herët, gjë që e dëshmon shkrimi më i vjetër 'Epi i Gilgameshit'. Gjoro Shushnjq te *'Fuqia dhe pafuqia e shkencës në kritikën e religjionit'*, pohoi se "të vërtetat shkencore gjithnjë janë jo të plota dhe relative. Njeriu ka nevojë për diç të plotë dhe absolute. Ato nevoja absolute i plotëson religjioni. Religjioni e plotëson nevojën që hipotetikja të shndërrohet në kategorike, e pasigurta në të sigurtë dhe e vdekshmja në të pavdekshme" [37]. Max Horkheimer, te *'Kritikë mendjes instrumentale'*, theksoi se "në esencë, religjioni ka depërtuar pakufishmërisht në të kufishmen, përjetësisht në kohëzgjatjen e kalimtares, ashtu që kjo

hierarki tashmë s'mund të ndahet nga gjuha" [182]. Kështu, shkenca dhe religjioni, si dy autoritete, e plotësojnë njëra-tjetrën. Gjoro Shushnjiq te *'Fuqia dhe pafuqia e shkencës në kritikën e religjionit'*, thotë se "shkenca dhe religjioni janë çelësa origjinal për hapjen e thesarit botëror, për ata që dinë t'i përdorin praktikisht cilëndo prej tyre". "Shkencëtari mund të ketë dije për atë çfarë nuk është ai vetë, andaj pikërisht për këtë i ikë vetëdija për veten e tij. I zënë dhe i preokupuar gjithnjë me angazhim, shkencëtari ndodhet përherë i kyçur në aksion, ashtu që nuk mund të gjejë (rezervojë) kohë për heshtje e qetësi, as dëshirë dhe as forcë që të mendojë për vetveten: kur thjesht do ta ndiejë se është. Ai identifikohet me aksionin në atë mënyrë sa asnjëherë s'mund t'i japë kuptim botës në të cilën jeton dhe vdes. Kjo vetëharresë në aktivitet, e cila rrjedh nga racionaliteti shkencor, bëhet burimi më i thellë i antihumanizmit dhe antiintelektualizmit. Njëmend shtaza është drejtpërdrejt unike me veprimtarinë e vet jetësore, por njeriu s'duhet të sillet si i tillë" [42-43]. Ai duhet të gjejë forcë mendore e logjike që të dalë nga vetja për të menduar për vetveten. Religjioni është treguar e dëshmuar shumë efikas edhe në ruajtjen e kohezionit dhe solidaritetit shoqëror, të cilin e hetoi Emil Dyrkemi [*Format elementare të jetës religjioze*] te shumë bashkësi e shoqëri religjioze.

Sot, kur në shumë shtete janë shtuar format e keqqueverisjes, nepotizmit, korrupsionit dhe dukurive tjera negative, nevoja për njerëz religjioz që interesin e përgjithshëm - atë të popullit e vendosin mbi interesin e tyre, është nevojë e jashtëzakonshme. Njerëzit e tillë nuk zbresin nga qielli. Ata duhet të edukohen në një proces të gjatë socializues - edukativ e arsimor, të mbështjellur me bindje e besim të shëndoshë në Zot. Është dëshmuar se vetëm dituria laike e zhveshur nga besimi, nuk është e mjaftueshme për tejkalimin e problemeve shoqërore. Shtrëngimi i ligjeve dhe vendosja e gjithandejshme e kamerave survejuese, nuk krijon virtyte, as karaktere dhe as veprime të moralshme. Ato mund të ofrojnë vetëm zgjidhje momentale për disa probleme, por kjo megjithatë është larg krijimit të një shoqërie të shëndoshë e humane në kuptimin e plotë të fjalës. Në mungesë të kësaj, sot njeriu është atomizuar, është fragmentuar dhe është robotizuar. Atij lipset t'i jepet edukatë fetare në shkolla, ashtu që krahas dijës shkencore, të marrë edhe edukatën religjioze, që krahas mësimit ta ketë edhe besimin.

## CONCLUSION

In order to understand the role of religion in human life, it is important to refer to Blaise Pascal's "heart's reason" melted in the oath that should remove the curtain of disbelief to any atheist, skeptic and agnostic: "If God does not exist, while I have believed, after my death I will have no harm for what I have believed; but if God exists, and I have believed, after my death I know that He will reward me for having believed Him." In this context was the answer given by the priest converted to an Islamic preacher Ahmet Deedat to an atheist: "How would you feel that if after death you were informed somehow that all what you believed to that faith has in vain?" To that, Deedat replied: "Of course I would not feel worse than you when you'd understand that what you have denied was true."

## LITERATURA

1. Levinas, Emanuel, *Etika dhe pafundësia*, Fryma, Dukagjin, 2003
2. Eco, Umberto, *Struktura e papranishme*, Fryma, Dukagjin, 2003
3. Ferri, Lyk, *Homo Aestheticus, Shpikja e shijes në epokën e demokracisë*, Elena Gjika, Tiranë, 2002
4. Platoni, *Apologjia e Sokratit*, Rilindja, Prishtinë 1986
5. Locke, John, *Letër për Tolerimin*, Plejad, Tiranë, 2002
6. Bacon, Francis, *Atlantida e re*, Rilindja, Prishtinë 1982
7. Berkeley, George, *Traktat mbi parimet e njohjes njerëzore*, Phoenix, Tiranë, 2002
8. Zhan Zhak Ruso, *Kontrata sociale*, Rilindja, Prishtinë, 1977
9. Nietzsche, Friedrich, *Shndërrimi i të gjitha vlerave*, Eugen, Tiranë, 2002
10. From, Erich, *Njeriu për vete*, Phoenix, 2003
11. From, Erich, *Psikoanaliza dhe feja*, Plejad, Tiranë, 2002
12. Friedrich, Nietzsche, *Antikrishti*, ASD, Tiranë, 2000
13. Horkheimer, Max, *Pomraçenje uma*, Veselin Masleša, Svjetlost, Sarajevo, 1989
14. Horkheimer, Max, *Kritika instrumentalnog uma*, Globus, Zagreb, 1988
15. Shushnjq, Gjoro, *Fuqia dhe pafuqia e shkencës në kritikën e religjionit*